



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:047331

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06104458

KA. nr. 781/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “3ANGLO” SH.P.K, me numër unik identifikues 811458042, me seli në Mitrovicë, e përfaqësuar nga E.R., sipas autorizimit të datës 31.12.2020, kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit- Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërorë me përfaqësues Nexhmije Karaqi, për shkak të heshtjes administrative sipas ankesës kundër vendimit të Komunës së Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020 me te cilin i është refuzuar kërkesa për leje ndërtimi/vendosje te shkalleve metalike, pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur konform nenit 41 të LKA-së, në të njëjtën ditë me datë 23.08.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “3ANGLO” SH.P.K, me numër unik identifikues 811458042, me seli në Mitrovicë,
- II. OBLIGOHET e paditura Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, tani Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinorë në Qeverinë e Republikës së Kosovës që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi,
 - 1). ta shqyrtoj ankesën e paditësit Ankesën me nr. 05.nr.070/01-2547/21 të datës 08.01.2021 kundër vendimit të Komunës së Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020 e parashtruar me datë 31.12.2020

2). të merr vendim dhe të njëjtin, t'ia dorëzoj paditësit dhe Komunës së Prishtinës, sipas procedurës së përcaktuar me ligj dhe ta njoftoj gjykatën.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me dt. 12.03.2021, në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti Administrativ, paditësi “3ANGLO” SH.P.K, me numër unik identifikues 811458042, me seli në Mitrovicë, e përfaqësuar nga E.R., sipas autorizimit të datës 31.12.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit- Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore me përfaqësues Nexhmije Karaqi, për shkak të heshtjes administrative sipas ankesës kundër vendimit të Komunës së Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale sipas Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale lënda është transferuar në Departamentin Administrativ të Gjykatës Komerciale dhe është evidentuar me numër KA 781/22.

Gjykata me datë 23.08.2024 caktoj seancë të shqyrtimit kryesor, seanca u mbajt në mungesë të përfaqësuesit të paditësit, pasi gjykata konstatoj se përfaqësuesi i paditësit avokati E.R. është ftuar për seancë në mënyrë të rregullt, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 03.08.2024, dhe në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur Nexhmije Karaqi e cila për seancë ka dorëzuar parashtrësë dhe i ka propozuar që seancë të mbahet pa prezence të paditurës, prandaj seanca u mbajt në mungesë të përfaqësuesve të palëve ndërgjëgjëse, konform nenit 41 të LKA-së. Në seancë në mungesë të palëve u lexuan: Padia e datës 12.03.2021, Përgjigja në padi e datës 16.04.2024 dhe parashtrësja Deklarim për seancë e datë 07.08.2024 nga Avokatura Shtetërore, si dhe u administruan provat: vendim mbi refuzim të kërkesës së paditësit me numër 05 nr. 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020 të nxjerrë nga Komuna e Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm, Ankesën me nr. 05.nr.070/01-2547/21 të datës 31.12.021 kundër vendimit të Komunës së Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020 e parashtruar me datë 31.12.2020, Akt përcjellës i Komunës së Prishtinës, me datë 11.01.2021 për MEA.

Paditësi në padi të datës 12.03.2021, deklaroi se i pakënaqur me vendimi e Komunës së Prishtinës me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për leje për vendosjen e shkallëve metalike në ndërtesën shumë banesore “Residio 4” në parcelën kadastrale Mati 1, Nr. 1580-0, Blloku Urban A-24, ka parashtruar ankesë me datë 31.12.2021, mirëpo nuk ka marrë asnjë përgjigje nga e paditura.

Përfaqësuesja e të paditurës Nexhmije Karaqi nga Avokatura Shtetërore, në përgjigje në padi të datës 16.04.2024 dhe parashtrësë për deklarim për seancë e datë 07.08.2024, ka deklaruar se e kundërshton si të pabazuar kërkesëpadinë me arsyetim se vendimi i kundërshtuar është marrë në konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, dhe i propozon gjykatës ta refuzoj padinë dhe ta lë në fuqi vendimin e kundërshtuar.

Nga Akti përcjellës i Komunës së Prishtinës i datës 11.01.2021 Komuna e Prishtinës e ka referuar Ankesën e paditësit kundër vendimit me numër 05 nr. 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020, tek e paditura Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e cila nuk ka marrë asnjëherë vendin lidhur me ankesën. Për më tepër në përgjigje në padi e paditura, nuk i referohet fare heshtjes administrative, nuk jep asnjë arsyetim se pse nuk është marrë një vendim nga e paditura sipas ankesës së palës ankuese, këtu paditësit, megjithatë deklaroi se vendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore – pa e ditur as vet se për cilin vendim është duke u deklaruar.

Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shkak të heshtjes administrative është e bazuar dhe se paditësit nga e paditura i është shkelur e drejta në ankesë e garantuar sipas me dispozitat ligjore dhe kushtetuese.

Sipas LKA, Neni 29 paragrafi 3 përcakton *nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa.*

Prandaj, konform nenit 65 të LKA-së e paditura obligohet që ta shqyrtoj ankesën e paditësit Ankesën me nr. 05.nr.070/01-2547/21 të datës 08.01.2021 kundër vendimit të Komunës së Prishtinës- Drejtoria për Urbanizëm me numër 05 nr 353/04-179642/20 të datës 04.11.2020 e parashtruar me datë 31.12.2020 dhe ta njoftoj gjykatën, paditësin dhe Komunën e Prishtinës.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.781/22, datë 23.08.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:047331
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06104458